**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 5454/1 Prot. Tiranë, më 01.08.2024

**VENDIM**

**Nr. 07 Datë 01/08/2024**

**"PËR
DISA SHTESA NË MANUALIN TEKNIK QË SHOQËRON UDHËZIMIN NR. 4, DATË 18.06.2021 "PËR HARTIMIN E REGJISTRIT TË PARASHIKIMEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE REGJISTRIT TË REALIZIMEVE TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT DHE KRIJIMI I TYRE NË SISTEMIN E PROKURIMIT ELEKTRONIK"**

Në mbështetje të shkronjës "c", të nenit 23 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, si dhe neneve 87 dhe 115 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP")

**Vendos:**

Në Manualin Teknik që shoqëron Udhëzimin e APP Nr. 4, datë 18.06.2021 *"Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik"*, bëhen këto shtesa:

- Tek seksioni *"Regjistri i realizimeve të procedurave të prokurimit publik",* shtohen hapat sipas Manualit, bashkëlidhur, ku jepen shpjegime se si do të shënohet si "E realizuar" një element regjistri, për të cilin nuk krijohet procedurë prokurimi në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Reida Kashta**

Krijimi i elementit të regjistrit do të krijohet me të njëjtat hapa të parashikuara në Udhëzimin Nr. 04 datë 18.06.2021 "*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik*".

Ndryshimi konsiston në mënyrën sesi do të shënohet si "E realizuar" një element regjistri, për të cilat nuk krijohet procedurë prokurimi në sistem, por zhvillohen në rrugë shkresore dhe shënohen si "E Realizuar" nga llogaria e administratorit të sistemit, funksionalitet i cili tashmë do të shënohet nga nëpunësi i autorizuar.

Nëpunësi i autorizuar pasi klikon në tabin "Elementë të Regjistrit", i shfaqen të gjithë elementët e regjistrit të krijuar gjatë gjithë vitit.




Pasi klikon mbi elementin e regjistrit, nëpunësi i autorizuar duhet të klikojë në tabin "Shëno si e Realizuar" dhe menjëherë i shfaqet forma e mëposhtme ku duhet të plotësojë fushat: "Fituesi", "Vlera e fituesit pa TVSH", "Data e lidhje së kontratës", "Arsyeja" dhe "Numri i faturës".


Formulari
Informacion
Objekti i Prokurimit
Blerje nen 100 000
Fituesi
Vlera e fituesit pa TVSH
Data e Lidhjes se Kontrates
Kategorite e regjistrit
Blerje nen vleren 100 000 Leke
Numri i Faturës
Tjeter
Mbyll


Formulari
Informacion
Objekti i Prokurimit
Blerje nen 100 000
Fituesi
EconomicOperator1 0F3A994B-0009-4411-BFA9
Vlera e fituesit pa TVSH
75000
Data e Lidhjes se Kontrates
19.06.2024
Kategorite e regjistrit
Blerje nen vleren 100 000 Leke
Numri i Faturës
10
Tjeter
Mbyll

Pasi klikon në butonin “Tjetër”, menjëherë ky element regjistri i shfaqet administratorit të sistemit në skedarin “Të pa realizuara”.




Administratori i sistemit duhet te klikojë mbi elementin e regjistrit, më pas në tabin “Për tu konfirmuar” dhe i shfaqet tabi në të cilin mund ta aprovojë ose refuzojë veprimin.




Menjëherë pas konfirmimit të fituesit të parë, nëpunësi i autorizuar do të vijojë me hedhjen e faturave të tjera.

Të gjithë elementët e regjistrit të cilët do të konfirmohen si të realizuar nga administratori i sistemit do shfaqen në tabin “Të realizuara” në llogarinë e nëpunësit të autorizuar.

Nëpunësi i autorizuar pasi të klikojë mbi tabin “Të realizuara” dhe të përzgjedhë elementin e regjistrit, me atë të butonit “Menaxho fituesit”, do të ketë mundësinë të shtojë dhe të anullojë fitues në rast të përzgjedhjes gabim të ndonjë fituesi.

Në rast se nëpunësi i autorizuar dërgon për aprovim një faturë tek administratori i sistemit, kjo faturë shfaqet në statusin “Në pritje”.




Administratorit të sistemit do ti shfaqen të gjithë fituesit në tabin “Menaxhimi i fituesve”.

Në rubrikën “Fitues të shtuar” do të shfaqen të gjithë fituesit, të cilët janë shtuar nga nëpunësi i autorizuar dhe duhet të aprovohen nga administratori i sistemit.

Në rubrikën “Fitues të anulluar”, do të shfaqen të gjithë fituesit, të cilët duhet të anullohen nga administratori i sistemit pasi janë shënuar gabim nga nëpunësi i autorizuar.

Administratori i sistemit mund të konfirmojë fituesin e shtuar duke klikuar mbi fituesin e shtuar dhe klikon mbi butonin “Për tu konfirmuar”.



Në rast se nëpunësi i autorizuar do të bëjë anullim të një fituesi, duhet të klikojë mbi elementin e regjistrit në skedarin “Të Realizuara”, dhe më pas në butonin “Anullo fituesin”.

Pasi vendos arsyen e anullimit të fituesit, klikon butonin “Anullo fituesin” dhe pret konfirmim nga administratori i sistemit.



Administratori i sistemit në skedarin “Fitues të anulluar” verifikon dhe konfirmon anullimin e shtuar nga nepunësi i autorizuar.

